

Dr. Musli Vërbani

**Tregime të kafshëve, shpendëve dhe
insekteve të përmendura në Kur'an dhe në
historinë Islame**

(365 tregime për fëmijën tuaj brenda 12 muajve të vitit)

Kaçanik, 2020

Titulli:

Tregime të kafshëve, shpendëve dhe insekteve të përmendura në Kur'an dhe në historinë Islame


Autor:

Dr. Musli Vërbani

Korrektues:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori



**Tregime të kafshëve,
shpendëve dhe insekteve të
përmendura në Kur'an dhe në
historinë Islame**



Peshku i Junusit a.s.

Junusi a.s. ishte dërguar prej Allahut për tek populli i tij.
 Populli i tij nuk e dëgjonte.
 Një ditë prej ditëve u hidhërua me popullin e tij.
 U largua prej tyre pa marrë leje nga Allahu,
 mendoi se Allahu nuk do ta sprovtojë
 dhe se nuk do t'i vijë më puna ngushtë.
 Pasi u largua, hipi në një anije.
 Duke lundruar anija, filloi mot i lig, erërat e forta lëkundnin anijen,
 retë e zeza e kishin mbuluar qiellin, binte shi i madh.
 Anija lëkundej, gati sa nuk rrëzohej.
 Udhëtarët e anijes mendonin se ndonjëri prej tyre është fatkeq
 dhe për të u qetësuar deti dhe moti duhet të hidhet në det njëri prej udhëtarëve.
 Për të hedhur në det njërin prej udhëtarëve duhej të hidhej short.
 E hodhën shortin,
 shorti ra në Junusin, ata e panë se Junusi ishte duke fjetur, andaj nuk ia prishën gjumin.
 Ata hodhën short për së dyti.
 Prapë shorti i ra Junusit, prapë ata për shkak të respektit që kishin për të nuk donin ta shqetësonin.
 Hodhën short,
 edhe në herën e tretë i ra Junusit,
 këtë herë Junusi u zgjua vetë dhe e kuptoi se ka gabuar që është larguar nga populli i tij
 andaj ai vendosi që vet të hidhej në det, dhe u hodh.
 Kur ra në det e gëlltiti një peshk i madh.
 Zoti i Madhëruar e urdhëroi peshkun që mos ta dëmtojë trupin e Junusit, por vetëm ta mbaj sikur në burg.
 Junusi a.s. tani qëndronte në errësira të ndryshme:
 - Errësira e mbrëmjes;
 - Errësira e detit;
 - Errësira e barkut të peshkut.
 Junusi nuk e harroi Zotin e tij, iu lut Zotit të Lartmadhëruar:
Laa ilaahe il-laa ente subhaaneke in-nii kuntu minedh-dhaalimiinë.
“Nuk ka Zot pos Teje. Ti je i pastër, nuk ke të meta. Unë i bëra padrejtësi vetes!”
 Allahu i Lartësuar menjëherë iu përgjigj Junusit a.s., e shpëtoi nga tmerri sepse ai ishte besimtar i vërtetë. Zoti i Lartmadhëruar tregon në Kur'an kur thotë:
“Ne iu përgjigjëm atij, e shpëtuan nga tmerri. Kështu i shpëtojmë Ne besimtarët.”

Hud-Hudi ushtare e Sulejmanit a.s

Sulejmani a.s. ishte pejgamber.
Ai kishte ushtri të fuqishme.
Ushtria e tij përbëhej nga:
kafshët,
xhinët dhe
njerëzit.
Me fjalë tjera nga të gjitha llojet e krijesave.

Një ditë ai po e inspektonte ushtrinë e tij.
E kontrolloi numrin e shpendëve në qiell.
Në atë hapësirë mungonte pulëbardha **Hud-Hud**.
Ajo nuk ishte e rreshtuar me ushtarët tjerë të shpendëve.

Sulejmani a.s. tha:
- Kur të vjen pulëbardha do ta dënoj nëse ka munguar pa arsye.

Në anën tjetër Hud-Hudi kishte fluturuar mbi vendbanimet e mbretërisë së një mbretëreshë.
Ajo mbretëreshë ishte Belkisja.
Në atë mbretëri populli adhuronte diellin dhe hënën në vend të Allahut.
Hud-Hudi edhe pse ishte shpend i vogël dëshironte që ai popull të adhuronte vetëm Allahun dhe të mos i bënte sexhde diellit dhe hënës.

Pas një kohe paraqitet para Sulejmanit a.s.
Si ushtarë i denjë i raporton Sulejmanit a.s., i thotë: - Kam sjellë një lajm të rëndësishëm nga populli i Sebeit. **Kam takuar një popull që adhuronte diellin dhe hënën në vend të Allahut.**
Ai popull i binte në sexhde diellit e jo Allahut.

Lajmi i Hud-Hudit ndikoi që ai popull pastaj të bëhet musliman.

Hud-hudi dhe dërgesa: Bismilahirr-Rahmanirr-Rrahim

Hud-Hudi ishte një ushtar prej ushtrisë së Sulejmanit a.s.
Ishte duke fluturuar në qiell.
Nga lart pa një vendbanim.
Ai vendbanim ishte nën mbretërinë e Belkisës.
I mblodhi shënimet, e vështroi terrenin, e vërtetoi situatën.
Shkoi te Sulejmani a.s. dhe i tha: - Kam sjellë një lajm të rëndësishëm.
Popullin e Sebeit po e sundonte mbretëresha e quajtur Belkisë.

Sulejmani e shkroi një letër që fillonte me **Bismilahirr-Rahmanirr-Rrahim**.

Ia jep Hud-Hudit dhe i tha: - Merre këtë letër e dërgoje te mbretëresha Belkisë.

Hud-Hudi kaloi mijëra kilometra duke fluturuar.
Mijëra kilometra duke e përcjellë ftesën e besimit.
Hud-Hudi fluturoi dhe kaloi mbi Qabe.
Arriti tek Belkisja dhe ia lëshoi letrën në dhomën e saj,
me të cilën e ftonte që ta pranojë fenë islame.

Belkisja e sheh letrën në dhomën e saj.
I ftoi rojet dhe i pyeti se kush ka hyrë në dhomën e saj dhe e ka lënë atë letër?
Ata iu përgjigjën se nuk e dinë.

Belkisja e pa se çështja është serioze.
Thirri të gjitha shtresat, qeverinë, krerët e ushtrisë dhe dijetarët, dhe u tha:
- O populli im, më ka ardhur një letër ku shkruan:
Bismilahirr-Rahmanirr-Rrahim...
Kjo letër është nga Sulejmani. Ç'të bëjmë?
Njëri tha: - Të luftojmë.
Tjetri tha: - Lufta është e keqe.

Belkisja vendosi që të tuboj ari, diamant dhe stoli dhe t'ia dërgoj Sulejmanit a.s.
Sulejmani tha: - Unë nuk dua pasuri dhe nuk e pranoj.
Belkisja e kuptoi se Sulejmani nuk mund të korruptohet.
Në fund vendosi ta pranojë ftesën e Sulejmanit. Ajo tha:
- **Unë me Sulejmanin i dorëzohemi Zotit dhe ne jemi musliman.**

Me Belkisën i tërë populli iu dorëzuan Zotit të gjithësisë dhe pranuan islamin.

Viçi i arit dhe Samiriju

Në një kohë, në Egjipt, Allahu e dërgoi Musain a.s. që ta shpëtojë popullin e tij nga Firauni.

Firauni ishte mbret kriminel.

Pasi shpëtuan, u vendosën në një vend në Sina.

Si zakonisht gratë mbajnë stoli të arit me vete.

Në mesin e të ikurve ishte njëri i quajtur **Samirij**.

Samiriu ishte prej beni israilëve dhe ishte magjistar.

Zoti i Lartmadhëruar kërkoi që Musai a.s. të zgjedh shtatëdhjetë burra nga beni israilët dhe të ngjitet në kodër.

Musa a.s. qëndroi tridhjetë ditë, pastaj i vazhdoi edhe dhjetë ditë.

Gjatë këtyre katërdhjetë ditëve Samiriu tuboi arin nga gratë e beni israilëve, prej atij ari e ndërtoi një statujë në formë të viçit.

Pastaj e bëri që viçi të pëllet sikurse të jetë viç i gjallë.

Kur e dëgjuan beni israilët, Samiriju u tha: - Ky është Zoti juaj, këtë adhurojeni.

Populli filloi të sillej rreth tij dhe të këndojë, duke e besuar dhe duke e adhuruar si Zot. Nga 600 000 beni israilë, vetëm 12 000 prej tyre nuk e adhuronin viçin.

Zoti i Lartmadhëruar e lajmëroi Musain a.s. se populli i tij po e adhuronte viçin.

Musai a.s. i hidhëruar u kthye te populli pas 40 ditëve.

Shkoi te vëllai i tij Haruni a.s., e kapi për mjekre dhe i tha se pse e ka lejuar adhurimin e viçit.

Haruni a.s. i tha: - Unë u frikova se mos po shkaktoj përçarje në mes popullit.

Pastaj Musai a.s. e dogji viçin e arit,
e shkriu dhe e hodhi në det.

Samiriju shkoi në pyll, atje iu vërsulën kafshët e pyllit dhe e mbytën.

Deveja e Salihut

Salihu ishte peygamber.
Ai e udhëzonte popullin e tij.
Populli i tij kërkonte argument se a ishte ai peygamber.

Salihu tha: - Çka dëshironi?
Populli i tij tha: - Nga ky shkëmb le të dalë një deve
që të pimë qumësht prej saj.
Nëse e bën këtë, ne do të besojmë.

Salihu iu lut Allahut dhe menjëherë Allahu iu përgjigj lutjes së tij.
Nga shkëmbi doli një deve.
Deveja ishte me trup të madh, e zgjuar dhe e bukur.
Deveja bashkë me të voglin e saj, kullosnin dhe e përmendnin Zotin.

E pastaj Salihu tha: - Ju erdh argumenti prej Zotit tuaj.
Ja pra kjo është deveja e Allahut, argument për ju.
Lëreni të qetë të ushqehet në tokën e Allahut.
Mos i shkaktoni asgjë të keqe, se ju kaplon dënimi i dhimbshëm.

Një pjesë e popullit besuan.
Pjesa tjetër vetëm sa u dëshpërua dhe e shtoi mosbesimin.

Salihu i tha popullit të tij: - Kjo deve do të pijë një ditë (ujë nga kroi), ndërsa për ju është e caktuar dita tjetër.

Deveja vazhdimisht pinte ujë, qumështi i shtohej,
njerëzit pinin ujë ditën tjetër.

Gratë një pas një e milnin, ndërsa qumështi nuk i harxhohej, por vetëm se i shtohej.
Njerëzit u befasuan nga kjo mrekulli dhe e panë se kjo ishte diçka e jashtëzakonshme.

Në qytet ishin nëntë persona të njohur për krime dhe shkatërrime,
ata ishin pijanecë të fëlliqur.

Njëri prej tyre thoshte:

- Kjo deve po e pi tërë ujin dhe po e harxhon, andaj duhet ta heqim qafesh se nuk na duhet!

Tjetri thoshte:

- Ta mbysim devenë, ta vrasim Salihun me familjen e tij e të mos na hetojë askush.

Para se të agojë dita e mbytën devenë.

Zoti i Lartmadhëruar e shkatërroi atë popull.

Salihu dhe besimtarët shpëtuan.

Buburreci

Sulejmani a.s. ishte i drejtë.

Ishte i dashur për të gjithë.

E kuptonte gjuhën e kafshëve, shpezëve dhe të insekteve.

Një ditë Sulejmani a.s. me ushtrinë e tij po kalonte pranë një kodre.

Në atë kodrinë kishte buburreca.

Prijësi i buburrecave u thotë buburrecave tjerë:

- Hyni nëpër vendet tuaja që të mos iu shkel Sulejmani me ushtrinë, për shkak se nuk ju shohin.

Sulejmani i dëgjoi këto fjalë.

Ai filloi të qeshë.

Ai e falënderoi Zotin për këtë begati që i ishte dhuruar.

Edhe pse buburreci ishte i vogël,

përkujdesej për shoqërinë e buburrecave.

Nuk hyri në vendbanimin e tij pa iu treguar tjerëve.

Buburreci ka pasur ndjenja përgjegjësie:

Është përkujdesur për sigurinë e shoqërisë së buburrecave.

Është përkujdesur për qetësinë e shoqërisë së buburrecave.

Është përkujdesur për lumturinë e shoqërisë së buburrecave.

Përkujdesej për të mos u dëmtuar dhe për të mos u shkatërruar.

Në fund buburrecat hynë në strofujt e tyre dhe shpëtuan.

Elefanti nuk bindet

Ebreheja ishte nga Jemeni.
 Përgatit një ushtri të fortë për t'u futur në Mekë.
 Në krye të ushtrisë kryesonin elefantë të fuqishëm.
 Në ballë të Elefantëve qëndronte elefanti gjigant të cilin e quanin Mahmud.
 Elefanti iu afrua Qabes.
 Ai ndaloi dhe nuk iu bind atij që po e drejtonte.
 Njeriu që drejtonte Elefantin e fshikulloi me kamxhik në kurriz.
 Elefanti i madh, Mahmudi, i nguli këmbët në tokë dhe nuk ecte përpara.
 E goditën me sende dhe çengela sipër kokës, por ai nuk lëvizte vendit.

E drejtonin nga Siria, ikte menjëherë andej.
 E drejtonin nga Jemeni, po ashtu ikte me shpejtësi.
 Kur e drejtonin nga Meka ngulitej në Tokë.

Të gjitha përpjekjet e tyre ishin të padobishme, pasi elefanti filloi të tërhiqej.
 Ebreha, udhëheqësi i ushtrisë, u habit nga mënyra e sjelljes së elefantit.
 Ebreha habitej se pse elefanti refuzonte të përparonte drejt Qabes dhe bërtiti gjithë tërbim.
 Personi që kishte drejtimin e elefantit bëri ç'ishte e mundur për ta detyruar elefantin që të përparonte drejt Qabes, por elefanti nuk bëri as edhe më të voglin hap përpara.
 Ndërkohë ndodhi diçka e mrekullueshme.
 Elefanti u gjunjëzua dhe kështu që puna e personit që po e drejtonte u bë edhe më e vështirë.
 Elefanti përfundimisht nuk iu bind drejtuesit të tij, i cili tashmë ishte i pafuqishëm për ta kontrolluar.
 Në këto momente Allahu dërgon tufa të njëpasnjëshme shpendësh.
 Shpendët mbartnin tre gurë të vegjël të përbërë nga balta e thatë, një në sqep dhe dy në këmbë.
 Çdo gurë që binte në trupat e ushtarëve ishte shkatërrues.
 Vetë Ebrehaja u godit nga gurë të tillë dhe filloi t'i binte mishi copë-copë derisa vdiq.
 Nga të gjitha gjallesat që gjendeshin aty, vetëm elefanti Mahmud shpëtoi gjallë.
 Në këtë vit ka lindur Pejgamberi i fundit Muhamedi alejhis-selam.

Ishte një pasanik i cili e kishte djalin e vëllait të varfër. I pasuri nuk kishte trashëgimtar tjetër, pos këtij.

Pasi që shihej se jeta e tij do të zgjaste, djali i vëllait e mbyti për t'ia marr trashëgiminë dhe shkoi e hedh kufomën në një fshat tjetër.

Pasi që e hodhi atë në greminë, të nesërmen shkoi në atë fshat dhe ua kërkoi pagimin e gjakut.

Fshatarët e atij vendi shkojnë te Musa a.s. dhe kërkojnë prej tij që ta lutë Allahun që t'ia tregoj vrasësin.

Musa a.s. i urdhëroi që ta prejnë një lopë.

Ata i thonë:

- Si duhet të jetë ajo lopë!

Musai a.s. u tha:

- Ajo të jetë një lopë as plakë, as e re, por e mesme në moshë!

Ata i thonë:

- Çfarë ngjyre duhet të ketë ajo lopë!

Musai a.s. u tha:

- Ajo lopë duhet të jetë me ngjyrë të verdhë e cila shkëlqen.

Ata i thonë:

- Çfarë lloji duhet të jetë ajo lopë?

Musa a.s. u tha:

- Lopa s' duhet të jetë e lodhur nga lërimi apo nga ujitja e tokës, ajo lopë duhet të jetë e shëndoshë dhe pa asnjë të metë.

Ata shkojnë në treg dhe e blejnë lopën e një djali i cili është sjellë mirë me nënën e tij dhe i cili ishte rritur jetim dhe po ashtu edhe babën e kishte pasur të mirë.

Lopën e blejnë me ari aq sa ka peshuar lopa.

Pastaj e presin dhe me një pjesë të lopës i mëshojnë të vrarit. I vrari ngrihet i gjallë në këmbë me lejen e Allahut dhe thotë:

“Me ka vrarë djali i vëllait, pastaj prapë bie dhe në atë moment vdes.”

Atëherë djali të vëllait i ndalohet për të trashëguar pasurinë e axhës së tij.

Nëna, djali dhe lopa

Një njeri i mirë e kishte pasur një familje dhe një viç, e merr viçin dhe e shpie në një mal të pashkelur dhe thotë:

“O Zoti im, këtë viç po e lë në dorën Tënde për djalin tim kur të rritet.” dhe pas pak ai vdes.

Viçi kalon në atë pyll vite të tëra dhe ikte nga çdonjëri, saqë askush nuk mund ta shihte.

Kur djali i tij rritet, sillej mirë me nënën e tij. Ai natën e ndante në tri pjesë.

Në një pjesë falej, në një pjesë flinte dhe në një pjesë ulej te koka e nënës së tij.

Në mëngjes bartte dru me shpinën e tij, i shiste në treg aq sa kushtonin,

pastaj një të tretën e jepte sadaka, një të tretën e shpenzonte për vete dhe familjen, një të tretën ia jepte nënës së vet.

Një ditë prej ditëve nëna i thotë:

- Babai yt ta ka lënë në trashëgim një viç, të cilin e ka dërguar në një pyll. Shko në atë pyll dhe thirr: **Për Zotin e Ibrahimit, Ismailit e Is'hakut.** Kështu do të kthehet te ti. Shenjë e atij viçi është se kur ta shohësh shkëlqen aq shumë, saqë do të të duket se prej qimeve të saj po dalin rrezet e diellit.

Ajo lopë quhet Lopa e arit për shkak të shkëlqimit dhe bukurisë së saj.

Shkon në atë pyll dhe e sheh duke kullotë dhe e thërret me të madhe:

- **Po të thërras, për Zotin e Ibrahimit, Ismailit e Is'hakut e të Jaëkubit.**

Ajo lopë i shkon pranë, ai e kap për qafe dhe niset për në shtëpi.

Duke ecur, lopa me lejen e Allahut flet:

- O djalosh, i cili sillesh mirë me nënën tënde. Hip mbi mua se do ta kesh më të lehtë gjatë udhëtimit.

Djaloshi ia kthen:

- Nëna ime nuk më ka thënë ashtu siç po kërkon ti për të të hipur, por më ka thënë të të mbaj për qafe.

Lopa i thotë:

“Për Zotin, po të kishe hipur, kurrë nuk do të më kishe parë.

Vazhdo rrugën se po qe se edhe kodrën e urdhëron që të shkulet në rrënjë, do të shkulet dhe do të ecte me ty për shkak të mirësjelljes tënde ndaj nënës.”

Çmimi i lopës që fliste

Një nënë i thotë djalit të saj të shkon në treg të shes një lopë tre dinarë dhe pa pëlqimin e saj të mos e shes më shtrenjtë. Djaloshi shkon në treg për ta shitur për tre dinarë.

Allahu e dërgon një melek në formë të njeriut për ta sprovuar se mos po vepron në kundërshtim me fjalën e nënës së tij dhe e pyet: - Sa e shet këtë lopë?

Ai i thotë: - Tre dinar, me këtë çmim pajtohet nëna ime.

Meleku i thotë: - Po e blej për gjashtë dinarë, por pa u konsultuar me nënën tënde.

Djaloshi i thotë: - Po edhe nëse më jep ari aq sa peshon kjo lopë, prapë nuk e jap pa u pajtuar nëna ime.

Shkon te nëna dhe ia tregon ngjarjen.

Nëna i thotë: - Mirë pra, shko dhe shite për gjashtë dinarë dhe thuaj se edhe unë pajtohem.

Shkon në treg e takon melekun në formë njeriu, i cili i thotë: - A u konsultove me nënën tënde?

Djaloshi i thotë: - Nëna më ka thënë që mos ta shes më pak se gjashtë dinarë dhe as më shumë pa u konsultuar me të.

Meleku në formë të njeriut i thotë: - Po e blej për dymbëdhjetë dinarë.

Djaloshi e refuzon dhe kthehet te nëna e vet dhe ia tregon rastin.

Nëna i thotë: - Ai i cili ka dashur ta blejë është melek në formë të njeriut dhe ka ardhur për të të testuar. Nëse edhe një herë të vjen thuaj: - A ta shesim këtë lopë apo jo?

Djaloshi shkoi dhe prapë u takua me melekun.

Meleku i thotë: - Shko te nëna jote dhe mbaje këtë lopë sepse Musai do ta blejë këtë lopë për shkak të një të vrari, i cili është vrarë prej beni israilëve dhe mos ia shitni pa ju dhënë aq dinarë sa peshon një vagë.

E mbajnë lopën. Allahu e ka caktuar që ajo lopë të prehej prej beni israilëve, sepse ato cilësi të cilat ia kërkonin ishin vetëm te ajo lopë, me qëllim që ai të shpërblehej për shkak të mirësjelljes ndaj nënës së tij. Lopën e blejnë me ari aq sa ka peshuar lopa.

E presin lopën dhe me një pjesë të lopës i mëshojnë të vrarit.

I vrari ngrihet i gjallë në këmbë me lejen e Allahut dhe thotë:

“Me ka vrarë djali i vëllait, pastaj prapë bie dhe në atë moment vdes.”

Atëherë djalit të vëllait i cili e ka vrarë axhën e tij i ndalohet për të trashëguar pasurinë e axhës së tij.

Sulejmani a.s. dhe buburreci

Sulejmani a.s. ka qenë i urtë.
E ka folur gjuhën e insekteve, shpendëve dhe kafshëve.
Një ditë prej ditëve e pyet buburrecin:
- Sa ushqim konsumon brenda vitit?

Buburreci i përgjigjet:
- Për një vit më mjaftojnë tre kokrra farë.

Sulejmani alejhis-selam e mbyllë në një kuti.
Në atë kuti vendos tre kokrra farë.

Kaloi një vit.

Sulejmani e hap kutinë dhe befasohet.
Buburreci kishte ngrënë vetëm një farë e gjysmë.
Sulejmani e pyeti buburrecin:
- Ti më the që ke nevojë vetëm për tre kokrra farë,
tani ke ngrënë vetëm një e gjysmë.

Buburreci i përgjigjet:
- Kur jam në liri e di që Allahu nuk më harron në furnizim.
Tani që më ke mbyllur në kuti, nuk jam i sigurt se nuk do të më harrosh,
prandaj kurseva edhe për një vit tjetër.

Zogjtë e Ibrahimit a.s.

Ibrahimi a.s. ka pasur dëshirë t'i vështrojë gjërat.
Ka pasur dëshirë t'i hulumtojë, t'i vërtetojë.
Ka pasur dëshirë ta studiojë gjithësinë dhe ambientin të cilin e rrethon.

Duke analizuar dhe studiuar forcohet besimi.
Duke analizuar dhe studiuar qetësohet zemra.

Ibrahimi a.s. një ditë e pyeti Zotin: - Si i ngjallë të vdekurit?
Zoti i tha: - A nuk po beson?
Ibrahimi tha: - Po gjithsesi besoj, por dëshiroj që të më qetësohet zemra ime.

Zoti i Madhëruar i tha: - Merri katër zogj dhe preji.

Përzieje gjakun e tyre dhe shpërndaji në katër anë të kodrave.

Shkuli puplat e tyre dhe shpërndaji në katër anë të kodrave.

Pjesët e trupit të tyre shpërndaji në katër anë të kodrave.

Pastaj ti thirri.

Ashtu veproi Ibrahimi.
Mori katër zogj, i preu.
E përzihu gjakun e tyre dhe i shpërndau në katër anë të kodrave.
Puplat e tyre i shpërndau në katër anë të kodrave.
Pjesët e trupit të tyre i shpërndau në katër anë të kodrave.

Pastaj i thirri zogjtë.

Kur papritmas i sheh se si pjesët e trupit të zogjve bashkohen në ajër.
Bashkoheshin krahët e shpendëve nga të katërt anët.
Bashkoheshin puplat nga të katër anët.
Bashkohej mishi nga të katër anët.
Bashkohej gjaku nga të katër anët.
U formuan zogjtë sikur në gjendjen e mëparshme dhe fluturuan në drejtim të Ibrahimit.
Kështu Zoti i ngjallë të vdekurit.

Udhëtari dhe qeni

Një ditë prej ditëve, një njeri mori një rrugë udhëtimi.
Gjatë rrugës fillon dielli të përcëllon,
udhëtari etet për ujë,
buzët shkrumbohen.
Filloi të hulumtojë për ujë që ta shuaj etjen.
Pas një kohe e gjen një bunar.
Zbret në brendi të bunarit, pi ujë dhe del nga aty pasi që e kishte shuar etjen.

Pasi del nga bunari, kur e sheh një qen i cili ishte i etur,
i cili ishte i lodhur saqë nuk mund të lëvizte nga rraskapitja.

Njeriu e shikoi me mallëngjim dhe mendoi: Ky qen është i etur njësoj si unë para pak kohe.
Filloi të mendojë si ta shuajë etjen e qenit.
Pastaj zbriti në bunar, e mbushi këpucën e tij me ujë.
E shtrëngoi këpucën fortë me dhëmbë.
Me duar e këmbë prapë u ngrit lartë.
Doli nga bunari dhe i dha ujë qenit.
Për këtë, e falënderoi Zotin.
Zoti, për këtë vepër të mirë ia fali mëkatet.

Deveja dhe Muhamedi a.s.

Një ditë Pejgamberi s.a.v.s. hyri në kopshtin e një shoku të tij.
Aty i afrohet deveja.
Nga sytë e devesë pikonin lot.
Pejgamberi s.a.v.s. me duart e tij fisnike fërkon devenë për koke,
e ajo pushon së qari dhe qetësohet.

Pejgamberi a.s. e kërkon pronarin e devesë.
Vjen një djalosh dhe i thotë: - Ajo është e imja.

Pejgamberi s.a.v.s. i thotë:

“A nuk i frikësohesh Allahut për shkak të kësaj kafshe që Allahu ta ka dhënë në pronësi?
Deveja po më ankohet se nuk po e ushqen sa duhet.
Deveja po më ankohet se po e lodh për së tepërmi.
Deveja po më ankohet se je duke e ngarkuar shumë.”

Kabili ishte njëri prej djemve të Ademit a.s.
Ai e kishte vrarë vëllanë e tij,
tashmë ai nuk dinte se ç'të vepronte,
nuk dinte se ç'të vepronte me trupin e vëllait të tij.

Allahu i dërgoi dy sorra para tij.
Dy sorrat filluan të ziheshin me njëra-tjetrën.
Njëra mbeti e ngordhur në vend.

Sorra triumfuese filloi të hapë një gropë me këmbët e saj.

Pastaj e shtyu sorrën e ngordhur drejt gropës.
Sorra germoi me kthetrat e saj një gropë.
Sorrën e mbytur e hodhi në gropë, dhe filloi ta mbulojë.

Kështu mësoi Kabili se çfarë duhet të bëjë me kufomën e të vëllait.

Kabili u ndërgjegjësua për një gjë të rëndësishme.
Ai tani e dinte se si ta mbulonte trupin e vëllait të tij të vdekur për ta mbrojtur nga ujqërit
dhe nga shqiponjat.
Ai filloi të germonte tokën me anë të një kocke të tharë e të hapte një gropë në tokë.
Nga vështirësia e kësaj pune ai djersiti.
Më në fund ai hapi një gropë të thellë.
Ai e vendosi trupin e vëllait të tij në atë gropë dhe e mbuloi.
Sorra e mësoi Kabilin se si ta varroste vëllanë.

Delja - pjesët më të mira dhe më të këqija të trupit

Llukmani i urtë ka qenë shërbëtor te një i pasur.

Një ditë, zotëria i tij e urdhëroi ta therë një dele dhe t'ia sjellë dy pjesët më të mira të mishit.

Llukmani e theri delen.

Ia dërgoi zotërisë së tij **gjuhën dhe zemrën**.

Kaloi një kohë,

përsëri e urdhëroi ta therë një dele dhe tani t'ia sjellë dy pjesët më të këqija të mishit.

Llukmani e theri delen.

Ia dërgoi zotërisë së tij **gjuhën dhe zemrën**.

I çuditur me sjelljen e tij, zotëria i thotë:

- Unë të urdhërova që të më sjellësh pjesët më të mira,
e ti më solle **gjuhën dhe zemrën**.

Pastaj të urdhërova që të më sjellësh dy pjesët më të këqija,
ti përsëri më solle **gjuhën dhe zemrën**.

Ku është fshehtësia e sjelljes tënde në këtë mënyrë?

Llukmani u përgjigj:

Nuk ka gjë më të bukur se **gjuha dhe zemra kur janë të pastra**.

Nuk ka gjë më të keqe se **gjuha dhe zemra kur janë të prishura**.

Ishte një ditë e nxehtë.

Një Pëllumb po fluturonte mbi kodrat e rërës.

Vendosi të bëjë një fole mu në hyrje të shpellës së quajtur Thevr.

Përplasë krahët me tërë fuqinë dhe fluturon për në shpellë.

Në hyrje të shpellës Thevr ndërtoi një fole.

Brenda shpellës ishin Muhamedi a.s. dhe shoku i tij Ebu Bekri.

Muhamedi a.s. ishte duke migruar nga Meka për në Medine.

Kurejshitët iu afruan shpellës.

Njëri tha: - Mos ndoshta janë në shpellë dhe i zëmë për së gjalli.

Disa propozuan të hynin e të shihnin brenda.

Kur u afruan në hyrje të shpellës, idhujtarët e kishin parë folenë e pëllumbave dhe rrjetën e merimangës.

Deri sa ata vërtiteshin djathtas e majtas shpellës thoshin:

- Po të kishin hyrë në shpellë, veza e pëllumbit do të ishte thyer dhe rrjeta e merimangës do të ishte prishur!

Ebu Bekri i tha: - O i Dërguari i Allahut, po qe se ndonjëri prej tyre përkulet dhe sheh brenda në shpellë, na dallon nga këmbët që jemi këtu!

Ebu Bekri r.a. përjetonte çaste delikate. Ishte i frikësuar.

Jo për vete, por për të Dërguarin.

Pejgamberi a.s. qetësisht i thotë Ebu Bekrit:

- O Ebu Bekr! **Mos u pikëlllo e mos u shqetëso se Allahu është me ne!**

Pas tri ditëve vazhduan rrugën për në Medine.

Allahu e kishte urdhëruar të Dërguarin e Tij të mërgojë.
 Muhamedi a.s. u mor vesh me Ebu Bekrin dhe u nisën për Medine.
 Në fillim shkuan në shpellën Thevr.
 Gjatë kësaj kohe, idhujtarët ishin vënë pas Pejgamberit dhe Ebu Bekrit.

Hynë brenda shpellës ku u fshehën.

Gjatë kësaj kohe hynë në shpellë. Një merimangë thuri një rrjetë të madhe me të cilën e zuri tërë hyrjen e shpellës.

Idhujtarët i qenë afruar shumë shpellës.

E kishin parë folenë e pëllumbave dhe rrjetën e merimangës dhe duke menduar se aty merimanga e ka thurur rrjetin para një kohe të gjatë, thanë se është e pamundur të ketë hyrë brenda shpellës ndonjë njeri. Andaj ata nuk hynë në shpellë dhe u larguan.
 Rrjeti i merimangës dhe pëllumbi me vezët në anën tjetër u bënë mburojë për Muhamedin a.s.
 Umejje bin Halef u tha: - A s'keni fare mend ju? Ç'punë keni në shpellë?
 A mos do të hyni në këtë shpellë me rrjeta merimange një mbi një? Sipas mendimit tim, kjo rrjetë merimange është e një kohe para lindjes së Muhamedit!
 Ebu Bekri i tha: - O i Dërguari i Allahut, po qe se ndonjëri prej tyre përkulet dhe sheh brenda në shpellë, na dallon nga këmbët që jemi këtu!
 Ebu Bekri r.a. përjetonte brenda në shpellë çaste delikate. Ishte frikësuar. Jo për vete, por për të Dërguarin.
 Pejgamberi a.s. i thotë Ebu Bekrit:
 - O Ebu Bekr! **Mos u mërzit e mos u shqetëso se Allahu është me ne!**
 Pas tri ditëve vazhduan rrugën për në Medine.

Gjarpri i Musait a.s.

Ishte ditë feste.

Njerëzit ishin mbledhur dhe prisnin me padurim.

Erdhën magjistarët nën duartrokitjet e turmës.

Erdhi Faraoni, brohoritjet e mbuluan sheshin.

Kur erdhi Musai me të vëllanë, Harunin, ra një heshtje e thellë.

Musai ndenji në cep të sheshit dhe lutej në heshtje.

Magjistarët të gjithë së bashku lëshuan shkopinj të litarët që mbanin në dorë.

Sheshi u mbush me gjarpërinj, të mëdhenj e të vegjël.

Që të gjithë lëviznin, të gjithë përdridheshin.

Fillimisht njerëzit i zuri frika, por pastaj shpërthyen duartrokitjet.

Musai ishte i qetë.

Lëshoi shkopin që mbante në dorë mu në mes të sheshit.

Me të prekur në tokë, shkopi u shndërrua në një gjarpër të vërtetë.

Nuk ishte iluzion, nuk ishte si të tjerët.

Magjistarët shtangën, Faraoni u tremb.

Gjarpri iu drejtua shkopinjve e litarëve që kishin hedhur magjistarët e që dukeshin si gjarpërinj dhe i gëlltiti një nga një.

Pastaj iu afrua Musait, i cili e preku me dorë dhe gjarpri u kthye menjëherë në shkopin e mëparshëm.

Magjistarët e kuptuan.

Ishte mrekulli mbinatyrore e cila u dhurohet vetëm pejgamberëve dhe menjëherë u përkulën dhe thirrën: **“Ne e besojmë Zotin e Musait e të Harunit, Zotin e vërtetë të gjithësisë!”**

Faraoni u kthye nga magjistarët dhe u tha: - Si guxon t'i besoni Musait pa më marrë leje mua? Unë do t'ju pres duart e këmbët, pastaj do t'ju var nëpër pemë. Pastaj do e shohim kush guxon të kundërshtojë këtu.

Ata thanë: - Bëj ç'të duash!, ne nuk heqim dorë nga Musai. Ne besuam Zotin.

Shpresa jonë e vetme është që Ai të na i falë mëkatet e derisotshme.

Dëshira jonë e vetme është të shkojmë në xhenet, pranë Zotit!

Miza dhe Nemrudi

Nemrudi ishte mbret kriminel.

Ai ishte tallur edhe me peygamberin Ibrahim a.s.

Për shkak të kryelartësisë së tij dhe krimeve të tij, Zoti i madhëruar e dënoi Nemrudin.

Ia dërgoi një mizë e cila i hyri në vesh.

Ajo mizë ditë e natë i lëvizte në brendi të veshit të tij.

Nemrudi nuk mund të flinte natën.

Nuk mund të pushonte as ditën.

Nga mundimet e mizës e rroku çmenduria.

Nemrudi u tha bashkëpunëtorëve që t'ia heqin kokën dhe t'ia vendosin një kokë prej arit.

Ata i thanë: - Po ti atëherë do të vdesësh.

Ai me çmendurinë e tij tha: - Po a vdes Zoti?!

Ia ndërtuan një kokë prej arit, ia sollën.

Ia prenë kokën dhe vdiq.

Zotit nuk mund t'i shpëtojnë pabesimtarët!

Një ujku kishte sulmuar tufën e dhive.
Tufa e dhive ishte e Ukbanit.
Duke kapur një rënë prej dhive Ukbani e shpëton atë.
Ujku i drejtohet Ukbanit dhe i thotë:
- A nuk kishe frikë nga Allahu që ma more ushqimin tim?

Çobani çuditet pa masë dhe i thotë:
- Çudi! Si mund të flasë ujku?
Ujku i thotë:
- Çudi është puna jote, sepse pas kësaj kodre ndodhet një Pejgamber që ju thërret në xhenet, kurse ju nuk i besoni.

Çobani i thotë ujkut:
- Po të shkoj unë tek Pejgamberi, kush do të ma ruajë tufën?
Ujku i thotë:
- Ta ruaj unë.
Ukbani ia dorëzon tufën ujkut.
Shkon tek Pejgamberi, pranon Islamin.
Kur kthehet, e gjen ujkun duke ruajtur tufën e tij.
Asnjë dhi nuk mungonte.
Çobani e pret një dhi dhe ia jep ujkut për të ngrënë sepse ujku ishte ai që i tregoi për Pejgamberin dhe e ndihmoi atë të bëhet musliman.

Idhujtarët e Mekës i pengonte thirrja e Muhamedit a.s. për të besuar në vetëm një Zot. Ata vendosën që t'i bllokojnë ekonomikisht muslimanët: Muhamedin, familjen e tij dhe çdokënd që i përkrahte ata.

E nënshkruan një marrëveshje dhe e vendosën në Qabe.

Në marrëveshje ishte shënuar:

Muslimanët të largohen prej Mekes dhe të vendosen në shkretëtirë jashtë Mekkes.

Të mos blihet prej muslimanëve dhe të mos u shitet muslimanëve.

Të mos martohen muslimanët e as muslimanet.

Filluan vite të vështira për muslimanët.

Tri vite të plota me uri, vështirësi.

Tri vite të plota me etje, vështirësi.

Tri vite të plota vështirësi.

Gjatë kësaj kohe detyroheshin të hanë gjethet e dushkut dhe barishte.

Shkon krimbi dhe e grimcon pjesën ku ishte shkruar kontrata dhe ishte vendosur në Qabe, përpos pjesës ku ishte e shkruar NË EMËR TË ALLAHUT, këtë pjesë nuk e grimcon.

Muhamedi a.s. e thirr axhën e tij dhe i thotë:

O axha im! Zoti e ka urdhëruar krimbin që ta grimcojë letrën ku ishte nënshkruar kontrata dhe ishte vendosur në Qabe. Krimbi e ka ngrënë të tërën përpos pjesën ku ishte shkruar "NË EMËR TË ALLAHUT".

Ebu Talibi shkoi në Mekë dhe u tha pabesimtarëve të Mekës se kontratën të cilën e kishin nënshkruar e kishte ngrënë krimbi dhe kishte mbetur vetëm pjesa ku ishte e shkruar "NË EMËR TË ALLAHUT".

Pabesimtarët thanë se nëse kjo është e vërtetë, atëherë kontrata priset dhe besimtarët mund të kthehen nëpër shtëpitë e tyre dhe të vazhdojnë jetën e tyre.

Pabesimtarët shkuan në Qabe,

u befasuan kur e panë se atë çka kishte thënë Muhamedi a.s. ishte e vërtetë.

Kësisoj u thyë bllokada ekonomike ndaj tyre.

Muhamedi a.s. u kthye me familjen dhe besimtarët në Meke.

Gomari i Halimes

Halimja ishte grua e varfër.
Ajo e kishte një gomar.

Halimeja me Harithin, bashkëshortin, kishte mbetur ende pa iu gjetur një mëndeshë.
Halimeja filloi të shëtiste rrugëve e mërzhitur,
përpara i del gjyshi i Pejgamberit, AbdulMusalibi.
AbdulMusalibi e çoi Halimen menjëherë tek e ëma e fëmijës, Emineja.

Rruga për në fshat ishte e largët e muzgu ishte afruar.

Për fat të mirë gomari ecte me shpejtësi të madhe, thujse se nuk prekte nëpër tokë.
Në ato momente Halimja e kuptoi se foshnja Muhamed ishte e bekuar.

Ai gomar, i cili rrugës për në Mekë ishte aq dembel dhe i ngathët, tani dukej sikur fluturonte. Madje aq shumë sa i la mbrapa të gjitha gratë e tjera.

Gratë që nuk e kuptonin se çfarë po ndodhte, i folën Halimes:

- Oj Halime moj, a nuk është i njëjti gomar ky, me atë që erdhe për në Mekë?

A nuk ishte ai një gomar shumë i dobët dhe ngordhalaq?

- Po, i njëjti gomar është, mirëpo as unë nuk e kuptoj se ç'është duke ndodhur.

Madje shikojeni, unë as që po e ngas fare.

Ngarend vet me kaq shpejtësi.

Ky gomar i dobët ishte entuziazmuar jashtë mase.

Ai po mbante mbi kurrizin e tij Pejgamberin tonë të Nderuar.

Njerëzit nuk e kuptonin shpejtësinë e gomarit, gomari e dinte mjaft mirë.

Gomari i dobët i Halimes i tejkaloi të gjithë të tjerët.

Falë hapave të shpejtë të gomarit, ata mbërritën shumë shpejt në fshat.

Zogjtë Ebabil

Ushtarët e Ebrehesë iu afruan Qabës.
Ata mendonin se nuk ka ushtri e cila mund t'i ndalte.
Ata kishin vendosur ta shkatërronin Qabën.
Qabeja është shtëpi e Allahut.
Ebreheja me ushtarët e tij panë diçka interesante.
Diçka e ngjashme me re të zeza u shfaq në horizont.
Ato nuk ishin re, ato ishin tufa zogjsh që quheshin Ebabil.

Ata vinin nga drejtimi i detit.
Çdo zog mbante nga tre gurë, një në sqep dhe dy në kthetra.
Ishin gurë të vegjël prej zjarri.
I lëshonin gurët në madhësinë e lajthive nga sipër drejt e në kokat e ushtarëve.

Pasi largohej një tufë prej tyre, ushtrinë e sulmonte një tufë tjetër.
Ushtarët e panë veten në një kaos të tillë që s'dinin çfarë të bënin.
Çdo ushtar, të cilit i binte një prej këtyre gurëve, binte menjëherë i pajetë në tokë.
Ushtarët e Ebrehesë u rrëzuan të gjithë në tokë si miza.
Edhe vetë Ebreheja ishte një nga ata që u godit prej gurëve.
Prej gurit që e goditi, Ebrehesë iu thanë duart.
Krahët dhe këmbët iu bën sikur të kishin qenë gjethe të thara.
Dy ushtarë u munduan ta nxirrnin prej fushës së luftës, por për një kohë tepër të shkurtër atij iu thanë të gjitha organet duke iu kthyer në dhe.
Ai ndenji gjallë derisa iu tha edhe zemra.
Dhe pasi iu tha edhe zemra, ai u kthye i tëri në pluhur.

Buraku

Buraku është kafshë qiellore dhe nuk është tokësore.
Ngjyra e tij është e bardhë.
Shkëlqen me shkëlqimin e saj qiellor.
Shpejtësia e tij në vrapim është si shpejtësia e vetëtimës.
Nuk është gomar dhe është me i vogël se mushka.

Xhibrili së bashku me Burakun shkojnë te Muhamedi a.s.
Muhamedit a.s. i kërkohet që të ulet (të hip në të).
Hip Muhamedi a.s. mbi Burak.
Me Burak udhëton deri në xhaminë Aksa.
Kur arrin aty e lidh Burakun.
I falë dy rekata namaz në xhami.

Pastaj së bashku me Xhibrilin filloi udhëtimin drejt qiellit.
Ngritja në qiej quhet Miraxh.
Buraku ishte i nderuar se e kishte mbi vete Muhamedin a.s.

U quajt Burak për shkak të thellësisë së bardhësisë dhe shkëlqimit të tij, ashtu siç është edhe vetëtimja.

Kali i Surakës

Muhamedi a.s. me Ebu Bekrin ishin duke shkuar rrugës për në Medine.
Mekasit kishin vendosur shpërblim prej 100 deveve për atë që e zë Muhamedin a.s. para se të shkonte në Medine.

Suraka kishte një kalë.
Ai e merr kalin dhe u shkon pas për t'i zënë.

Hipur mbi kalë Suraka po ecte me shpejtësi në drejtim të tyre.

Para se t'u afrohej, Kali i Surakës rrëshqiti.
Suraka bie nga Kali.

Suraka hodhi fall.
I doli ashtu siç dëshironte dhe në zemër i hyri një trishtim i madh.

Hipi mbi Kalë.
U afrua tek ata aq shumë, por i dërguari i Allahut nuk po shikonte rreth e qark.
Ebu Bekri vështironte sa majtas e sa djathtas.
Suraka mendoi se tash ishte çasti më i volitshëm për ta kapur Muhamedin a.s.

Në atë moment i ndodhi diçka e çuditshme.
Kalit të Surakës i humbën këmbët në tokë deri në gjunjë.
Suraka ra nga kali.

E tërhoqi kalin dhe ai u çua, por me vështirësi ia nxori këmbët nga toka.

Pas shumë përpjekjesh, kali i nxori këmbët plotësisht.
Nga dheu i këmbëve të kalit u çua një pluhur që u ngjit në qiell si tym.

Ai e kuptoi se i Dërguari i Allahut do të triumfonte, prandaj u thirri atyre: **“Më prisni, se nuk do t’ju bëj asgjë të keqe!”**

Pejgamberi dhe Ebu Bekri u ndalën dhe e pritën atë.
Suraka iu tha se nuk do t’ju bënte atyre asgjë të keqe vetëm e vetëm ta lejonin të kthehej mbrapa.

Ashtu edhe ndodhi. Kali i Surakës më në fund u kthye kah kishte ardhur, ndërsa Muhamedi a.s. me Ebu Bekrin vazhduan rrugën për në Medine.

Gomari i Uzejrit

Ishte një mesditë.
 Dielli ishte ngjitur në zenit.
 Uzejri mori gomarin e vet dhe doli për rrugë.
 Vendosi të pushonte pak.
 Zbriti nga gomari.
 Nxori pak ushqim e pak fruta nga çanta dhe u ul të hante.

Zoti dërgoi menjëherë melekun e vdekjes dhe ia mori shpirtin.
 Gomari mbetet lidhur derisa ngordhi.

Kalojnë plot njëqind vjet.

Pastaj, me forcën e Zotit, atij trupi iu dha shpirt.
 Uzejri u ngrit nga vendi që kishte rënë, gjallë e i shëndoshë.
 Sapo ishte zgjuar nga një gjumë njëqindvjeçar i vdekjes u kujtua se ishte ndalur bashkë me gomarin për të pushuar pak gjatë rrugës së kthimit.
 Xhibrili që e kishte zgjuar prej gjumit, iu afrua dhe i tha:
 - Ke njëqind vjet që je i vdekur.
 Pa shikoj ushqimet tuaja, nuk kanë ndryshuar aspak.
 Vërtet që ushqimet ishin sikur i kishte lënë.
 Pa fiqtë, pjatën me ushqim që i kishte përgatitur vetes. Ishin njëlloj.
 Pastaj Xhibrili i thotë:
 - E sheh këtë?
 Është gomari yt.
 Uzejri e sheh pluhurin e kockave të gomarit bërë si miell.

- Më parë ky ishte Gomari yt – i tregoi Xhibrili.
 Me urdhrin e Zotit, u mblodhën kockat.
 Të gjithë kockat erdhën e u bashkuan duke marrë formën e një skeleti.
 Allahu xh.sh. komandoi nervat, muskujt e gjithçka tjetër të merrnin gjendjen e tyre të mëparshme.
 Më në fund u duk edhe lëkura e kafshës.
 Por ajo ishte ende e shtrirë aty, pa shpirt.
 Pastaj Allahu xh.sh. urdhëroi shpirtin të vishte trupin.
 Sapo i erdhi shpirti, gomari u hodh nga vendi.
 Tundi bishtin dhe nisi të ulërinte, se ishte shumë i uritur.
 Uzejri e sheh me sytë e vet mrekullinë e ringjalljes.

Dashi i Ismailit

Ishte një dash i bardhë,
me dy sy të gjerë,
me brirë të gjata.
Ishte i majmë dhe i trashë.
Kishte rëndësi të madhe.
Ai nuk ishte nga deshtë e tokës,
ishte dash që ishte ushqyer në xhenet.
Kishte kullotur në xhenet.
Ishte kurban i të cilin pati ofruar Habili, djali i Ademit a.s. dhe
që e pati pranuar Zoti dhe e pati ngritur në xhenet për të kullotur.

Ky dash u zbrit nga Qielli,
u flijua në vend të Ismailit a.s.
Ai ishte një dash i madh për nga rëndësia,
pasi do të flijohet në vend të një personazhi të madh, Ismailit a.s.
Ishte Zoti ai që e inspiroi që të therë dashin dhe jo të birin dhe
teksa tentonte të therë djalin, Ibrahim i a.s. dëgjoi një zë nga qielli.
Kur ktheu kokën, dalloj Xhibrilin a.s. me atë dash të majmë, duke zbritur nga qielli.

Prej Ibrahimit nuk pritej gjë tjetër veçse të respektojë urdhrin hyjnor.

“Dhe Ne e zëvendësua atë (Ismailin) me një kurban të madh.”

Ibrahimi a.s. e theri kurbanin,
e mbajti një pjesë nga mishi i tij dhe
pjesën tjetër e shpërndau tek nevojtarët,
si formë falënderimi që i shpëtoi Ismaili a.s.

Davudi a.s. dhe shpendët

Ishte një bari i dhenve.
Allahu i kishte dhënë bukuri.
Ishte adhures i madh, i qëndrueshëm në fe dhe i vendosur në besim.
Ishte i drejtë dhe dallohej për aftësinë që kishte për të gjykuar mes njerëzve.
Njihte gjuhën e shpendëve dhe të kafshëve.
I donte kafshët,
i ushqente dhe i mjekonte kur sëmureshin.
Kishte zë shumë të bukur.
Një ditë prej ditëve me zërin e tij të bukur këndonte Zeburin.
Pranë tij afrohen kafshët dhe e dëgjonin atë duke kënduar.
Mbi kokën e tij ndalen shpendët duke e dëgjuar.
Davudi a.s. i bënte tesbih Zotit.
Së bashku me të tesbih i bënin Zotit edhe kafshët në tokë.
Në qiell së bashku me Davudin edhe shpendët i bënin tesbih Zotit të Lartmadhëruar.

Bashkë me të bënin tesbih malet dhe kafshët.

Kafshët mblidheshin rreth tij.
Shpendët qëndronin në ajër.
Allahu i Lartësuar thotë:
“Edhe shpezët e tubuara, të gjitha, vetëm Atij i ishin drejtuar.”

Karkalecat e florinjtë

Ejubi a.s. kishte shëndet, fëmijë dhe pasuri.
Pastaj i ndodhi një sprovë.
I humbi pasuria.
I humbën fëmijët.
Iu dobësua shëndeti.
Pas shumë kohësh u shërua.

Pasi u shërua, një ditë Ejubi a.s. ishte duke u larë në një lum.

Allahu xh.sh. i lëshoi disa karkaleca.
Karkalecat ishin Karkaleca të florinjtë.
Ata ranë pranë tij.
Ejubi i pa se ishin prej floriri.

Ejubi a.s. mori rrobat dhe filloi t'i mbush me karkalecat e florinjtë.

Allahu xh.sh. i thotë Ejubit a.s.:

“O Ejub! A nuk të dhashë pasuri që të mos kesh nevojë për këto që shikon?”

Ejubi a.s. thotë:

“Sigurisht o Zoti im, por unë nuk ngopem me të mirat Tua.”

Peshku dhe Musai a.s.

Musai a.s. ishte nisur në udhëtim për të takuar Hidrin.

Në udhëtim e kishte bashkudhëtarin e tij.

Me vete e kishin një peshk në qese.

Musai a.s. flinte.

Bashkudhëtari e pa se si peshku del nga qesja dhe lëshohet në ujë.

Bashkudhëtari harroi t'i tregojë të dërguarit të Zotit, Musait a.s.

Këtë ia tha shumë vonë, kur ishin larguar nga rruga ku duhej të shkonin.

Musai a.s. e kuptoi se ka shkuar larg nga vendi ku u urdhërua të shkoj.

Sepse e kishte paraparë takimin me Hidrin.

U kthyen duke shikuar gjurmët deri tek vendi ku peshku hyri në ujë.

Ai nuk e qortoi shokun e vet.

Nuk u ankua pse kishte gabuar rrugën.

Ajo që ndodhi, ndodhi, ishte vullneti i Zotit.

Musai a.s. ishte i kënaqur me caktimin e Allahut.

Kur kuptoi se ka gabuar rrugën, mori të gjitha masat që të kthehet në rrugën e duhur.

U kthye deri te vendi i caktuar dhe e takoi Hidrin.

PESHKU I JUNUSIT A.S.....	7
HUD-HUDI USHTARE E SULEJMANIT A.S	8
HUD-HUDI DHE DËRGESA: BISMILAHIRR-RAHMANIRR-RAHIM	9
VIÇI I ARIT DHE SAMIRIJU	10
DEVEJA E SALIHUT	11
BUBURRECI	12
ELEFANTI NUK BINDET	13
LOPA.....	14
NËNA, DJALI DHE LOPA	15
ÇMIMI I LOPËS QË FLISTE	16
SULEJMANI A.S. DHE BUBURRECI.....	17
ZOGJTË E IBRAHIMIT A.S.....	18
UDHËTARI DHE QENI.....	19
DEVEJA DHE MUHAMEDI A.S.	20
SORRA	21
DELJA - PJESET MË TË MIRA DHE MË TË KËQJA TË TRUPIT	22
PËLLUMBI	23
MERIMANGA	24
GJARPRI I MUSAIT A.S.....	25
MIZA DHE NEMRUDI	26
UJKU	27
KRIMBI.....	28
GOMARI I HALIMES.....	29
ZOGJTË EBABIL.....	30
BURAKU	31
KALI I SURAKËS	32
GOMARI I UZEJRIT	33
DASHI I ISMAILIT	34
DAVUDI A.S. DHE SHPENDËT.....	35
KARKALECAT E FLORINJTË.....	36
PESHKU DHE MUSAI A.S.	37